

V E N D I M
Nr.313, datë 30.4.1996

PËR ZYRAT E PAJTIMIT DHE TË ARBITRIMIT

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pranë zyrave lokale të punës ngrihen zyrat lokale të pajtimit dhe arbitritimit.
Zyra Kombëtare e Pajtimit dhe Arbitritimit ngrihet në Tiranë pranë ministrit të Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.
Zyrat lokale të pajtimit janë kompetente për të trajtuar çdo konflikt që përfshihet në kompetencën e tyre territoriale.
Zyra Kombëtare është kompetente për të trajtuar çdo konflikt që kapërcen kompetencën territoriale të zyrave lokale.
2. Zyra e pajtimit ka për detyrë:
 - a) Të parandalojë dhe të pajtojë, në masën që është e mundur, konflikte kolektive që mund të lindin qoftë ndërmjet një punëdhënësi dhe punonjësve të tij apo organizatave të punonjësve, qoftë ndërmjet disa punëdhënësish apo organizata punëdhënësish dhe organizata punëmarrësish, në të njëjtin profesion dhe që lidhen me kushtet e punës, si dhe me interpretimin dhe zbatimin e kontratave kolektive.
 - b) Të favorizojë përfundimin e kontratave kolektive ndërmjet palëve të interesuara.
 - c) Të zgjidhë eventualisht konflikte kolektive me anë të një vendimi pajtimi.
3. Kryetari i zyrës së pajtimit është një nëpunës i zyrës lokale të punës, i caktuar nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë. Përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëmarrësve caktohen nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë për 2 vjet, mbi bazën e propozimit të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve më të përfaqësuar.
4. Quhen si të interesuar dhe që kanë cilësinë për të investuar zyrën e pajtimit, në kuptimin e këtij vendimi:
 - a) Organizatat e punëmarrësve dhe të punëdhënësve të krijuara në bazë të ligjit;
 - b) grupet e punëmarrësve dhe të punëdhënësve të të njëjtit profesion, të cilët pa plotësuar kushtet e parashikuara në shkronjën “a” provojnë apo duken në pamje të parë se përfaqësojnë një fraksion të rëndësishëm të punëmarrësve a të punëdhënësve në fjalë;
 - c) punëdhënësi që ka një konflikt kolektiv me punonjësit e tij, apo në të kundërtën, punonjësit me punëdhënësit e tyre.
5. Palët duhet të paraqiten personalisht. Ato kanë të drejtë të ndihmohen. Kryetari i zyrës ka të drejtë të kufizojë numrin e personave që pranohen gjatë debateve.
6. Në mungesë të një pajtimi të drejtpërdrejtë të palëve gjatë debateve, zyra e pajtimit vendos, me dyer të mbyllura, një propozim pajtimi.
Anëtarët e zyrës duhet të votojnë mbi këtë propozim. Shumica vendos, dhe në rast barazie votash, vendos vota e kryetarit.
Propozimi i pajtimit u njoftohet me shkrim palëve dhe në të njëjtën kohë atyre u caktohet një afat për të deklaruar me shkrim nëse e pranojnë apo jo këtë propozim. Debatet zhvillohen me dyer të mbyllura.
7. Nëse njëra nga palët nuk paraqitet pa ndonjë arsye të justifikuar, zyra e pajtimit ka të drejtë, pasi të ketë dëgjuar palën e pranishme dhe në bazë të dosjes, të vendosë një propozim pajtimi. Zyra ka të drejtë të shtyjë propozimin e saj për pajtim, nëse një propozim i tillë nuk mund të bëhet pa dëgjuar palën që nuk është e pranishme.
8. Kur propozimi i pajtimit hidhet poshtë nga njëra apo tjetra palë ose nga të dyja palët, atëherë palët kanë të drejtë të kërkojnë së bashku, që t’i drejtohen zyrës së arbitritimit, e cila është e ngarkuar për zgjidhjen e konfliktit.

9. Zyra e arbitrit përbëhet nga:

Kryetari që është një jurist, i caktuar nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, sekretari dhe përfaqësuesit e punëdhënësve e të punëmarrësve, që caktohen nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë për një kohëzgjatje prej 2 vjet, mbi bazën e propozimit të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve më të përfaqësuar.

Procedura fiksohet nga kryetari i zyrës së arbitrit.

10. Zyra e arbitrit ka për detyrë:

Të zgjidhë konflikte kolektive me anë të një vendimi arbitrimi, të cilat nuk kanë arritur zgjidhjen me anën e vendimit të pajtimit.

11. Procedura është falas. Anëtarët e zyrës së arbitrit dhe sekretari marrin shpërblime në bazë të orëve gjatë kohëzgjatjes së procedurës.

Këto shpërblime, si dhe shpenzime të tjera, janë në ngarkim të shtetit (për kryetarin dhe sekretarin) dhe në ngarkim të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve për përfaqësuesit e tyre.

Punëdhënësi përfaqësuesve të punëmarrësve duhet t'u japë leje pa të drejtë page, gjatë ditëve në të cilat ata marrin pjesë në seancat e zyrës së pajtimit.

Shpërblimi i tyre, i barabartë me pagën ditore, shumëzuar me numrin e ditëve, u jepet nga sindikata që ata përfaqësojnë.

12. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr.168, datë 22.3.1993 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve para lidhjes së kontratës kolektive të punës", dhe nr.169, datë 22.3.1993 "Për arbitrimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve para lidhjes së kontratës kolektive të punës", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi